

20130821840

L I G J PËR VEPRIMTARI FILMIKE

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Lënda e rregullimit

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen kryerja e veprimtarisë filmike, themelimi, puna, udhëheqja, menaxhimi, financimi, mbikëqyrja e punës dhe çështje tjera lidhur me punën e Agjencisë së Filmit të Republikës së Maqedonisë.

Dispozita të përgjithshme për veprimtarinë filmike

Neni 2

Zhvillimi, prodhimi, promovimi, shpërndarja dhe shfaqja publike e filmave janë me interes publik për Republikën e Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: veprimtaria filmike).

Neni 3

(1) Republika e Maqedonisë e nxit dhe e ndihmon zhvillimin e veprimtarisë filmike, veçanërisht nëpërmjet:

- mbështetjes së zhvillimit të veprimtarisë filmike,
- mbështetjes së vazhdueshme të prodhimit të filmave me interes nacional në veprimtarinë filmike,
- krijimit të kushteve të volitshme për zhvillim të infrastrukturës filmike,
- politikës fiskale stimuluese në sferën e veprimtarisë filmike,
- dhënies së bursve kuadrove deficitare në sferën e veprimtarisë filmike dhe
- prezantimit të organizuar të krijimtarisë filmike vendore në festivale dhe manifestime kulmore ndërkombëtare.

(2) Njësitë e vetëqeverisjes lokale në kuadër të kompetencave të tyre kontribuojnë për zhvillimin e veprimtarisë filmike në nivel lokal, nëpërmjet financimit të projekteve nga sfera e veprimtarisë filmike dhe nëpërmjet themelimit të institucioneve lokale nga sfera e veprimtarisë filmike, në pajtim me ligjin.

Interesi nacional në veprimtarinë filmike

Neni 4

Interesi nacional në veprimtarinë filmike në pajtim me këtë ligj paraqet:

- mbështetje të vazhdueshme të prodhimit të filmave vendorë,
- nxitje të krijimit të skenarëve vendorë,
- nxitje të koproduksioneve filmike ndërkombëtare me producentë të huaj në pajtim me marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare për këtë sferë,
- promovim ndërkombëtar të krijimtarisë filmike nëpërmjet pjesëmarrjes në festivale dhe manifestime filmike,
- mbështetje të festivaleve vendore me rëndësi ndërkombëtare,
- mbështetje të zhvillimit të kinemave në Republikën e Maqedonisë,
- mbështetje të shpërndarjes së filmave në Republikën e Maqedonisë,
- përsosje profesionale dhe të specializuar të kuadrove në sferën e filmit,
- nxitje të programeve edukative dhe arsimore nëpërmjet të cilave përparohet kultura filmike,
- mbrojtje të publikut, sidomos të publikut të mitur nëpërmjet kategorizimit të filmave që shpërndahen dhe shfaqen publikisht në Republikën e Maqedonisë,

- mbështetje të anëtarësimit të Republikës së Maqedonisë në organizata dhe asociacione filmike ndërkombëtare dhe
- mbështetje të botimit të librave dhe publikimeve për veprimtarinë filmike.

Strategjia për zhvillim të veprimtarisë filmike

Neni 5

(1) Për përcaktim të drejtimeve zhvillimore afatmesme për realizim të interesit nacional në veprimtarinë filmike, Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të Agjencisë së Filmit të Republikës së Maqedonisë, miraton Strategji për zhvillim të veprimtarisë filmike, për periudhë prej katër vitesh (në tekstin e mëtejshëm: Strategjia).

(2) Strategjia përmban:

- qëllime dhe prioritete për zhvillim të veprimtarisë filmike, masa organizative, administrative dhe financiare për zhvillim të veprimtarisë filmike,
- aktivitete për nxitje dhe mbështetje të pjesëmarrjes së Republikës së Maqedonisë në programet e Bashkimit Evropian dhe në organizatat tjera ndërkombëtare nga kjo veprimtari dhe
- çështje tjera me interes për zhvillim të veprimtarisë filmike në Republikën e Maqedonisë.

(3) Strategjia përmban edhe Plan aksional për realizim me aktivitete të përkufizuara, bartësit e aktiviteteve, masat për realizim, indikatorët për evalvim, afatet për realizim dhe burimet e mjeteve buxhetore dhe jashtëbuxhetore.

(4) Strategjia publikohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Kuptimi i shprehjeve të caktuara në këtë ligj (lista e nocioneve)

Neni 6

Shprehjet e caktuara të përdorura në këtë ligj e kanë kuptimin në vijim:

- "film" është vepër audiovizuale, si film artistik me metrazh të gjatë, film artistik me metrazh të shkurtër, film dokumentar dhe i animuar dhe vepër tjetër audiovizuale, që është shprehje artistike dhe autoriale pa marrë parasysh teknologjinë me të cilën është krijuar, bazën në të cilën është fiksuar dhe mënyrën në të cilën shfaqet, me përjashtim të TV-filmit dhe TV-programeve tjera të dedikuara për emetim radiodifuziv,

- "prodhim i filmit" janë aktivitetet kreative, organizative dhe financiare për bartje të skenarit të filmit në bazë nëpërmjet teknologjisë përkatëse,

- "përfundim i fundit" konsiderohet dita kur producenti i filmit do ta dorëzojë ekzemplarën e parë standard të filmit te Agjencia e Filmit të Republikës së Maqedonisë,

- "producent filmik" është personi juridik i regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë për kryerje të veprimtarisë prodhim i filmave si veprimtari kryesore, që i merr iniciativën, organizimin, financimin dhe përgjegjësinë për krijimin, prezantimin dhe shitjen e filmit dhe që i ndihmon regjisorit dhe ekipit të filmit në krijimin e filmit,

- "kryerës i shërbimeve në veprimtarinë filmike" është producenti filmik nga Republika e Maqedonisë, i cili në bazë të marrëveshjes me producentin e huaj të filmit, i ofron shërbime producentit të huaj të filmit për prodhim të plotë apo të pjesshëm të projektit filmik, përkatësisht televiziv në Republikën e Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: servisi i produksionit),

- "film vendor" është filmi:

- regjisor i të cilit dhe producenti i filmit janë nga Republika e Maqedonisë dhe në të cilin marrin pjesë shumë autorë, aktorë dhe artistë tjerë dhe punëtorë të filmit nga Republika e Maqedonisë,

- filmi i cili në 80% financohet me mjetet e Republikës së Maqedonisë,

- filmi i prodhuar nga një apo më tepër producentë të filmit nga Republika e Maqedonisë, me së paku një autor nga Republika e Maqedonisë dhe me pjesën kryesore të punëtorëve të filmit nga Republika e Maqedonisë apo

- filmi i prodhuar në bashkëpunim me producentë të huaj të filmit në pajtim me Konventën Evropiane për koproduksion në kinematografi;

- "filmi i koproduksionit" është filmi në të cilin pjesëmarrja e Republikës së Maqedonisë në shpenzimet e përgjithshme për prodhimin e filmit nuk mund të jenë më pak se 20% në koproduksion bilateral, përkatësisht jo më pak se 10% në koproduksion multilateral dhe
- "film me interes të posaçëm për Republikën e Maqedonisë" është filmi i cili e afirmon historinë e Maqedonisë.

II. THEMELIMI DHE PUNA E AGJENCISË SË FILMIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Themelimi dhe statusi juridik i Agjencisë së Filmit të Republikës së Maqedonisë

Neni 7

Për përkrahjen, nxitjen dhe zhvillimin e veprimtarisë filmike, financimin e projekteve me interes nacional për Republikën e Maqedonisë në veprimtarinë filmike, si dhe për përkrahjen, prezantimin dhe përkujdesjen për krijimtarinë filmike në Republikën e Maqedonisë, themelohet Agjencia e Filmit e Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtutjeshëm: Agjencia).

Neni 8

Puna e Agjencisë bazohet në principet në vijim:

- specialitet,
- profesionalizëm,
- transparencë dhe
- llogaridhënie dhe përgjegjësi për punën dhe për rezultatet e arritura.

Neni 9

- (1) Agjencia ka cilësi të personit juridik dhe është e pavarur në punën e saj.
- (2) Agjencia ka statut me të cilin rregullohen: shenja dhe emri i Agjencisë, emri i shkurtuar, emri për përdorim jashtë vendit, selia, lënda dhe mënyra e kryerjes së veprimtarisë, organizimi i Agjencisë dhe çështje tjera me rëndësi për punën e Agjencisë të përcaktuara me këtë ligj.
- (3) Për statutin e Agjencisë, jep pëlqim Qeveria e Republikës së Maqedonisë.
- (4) Agjencia për punën e saj përgjigjet para Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.
- (5) Enti Shtetëror për Revizion njëherë në vit kryen revizion mbi punën e Agjencisë.

Kompetenca e Agjencisë

Neni 10

Agjencia i kryen punët në vijim:

- financon projekte me interes nacional në veprimtarinë filmike,
- grumbullon mjete për financimin e projekteve me interes nacional në veprimtarinë filmike,
- e propozon dhe e zbaton Strategjinë për zhvillim të veprimtarisë filmike,
- e nxit zhvillimin e skenarëve filmikë vendorë,
- jep përkrahje për realizimin e koproduksioneve filmike ndërkombëtare në pajtim me marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare për këtë sferë,
- realizon bashkëpunim ndërkombëtar me institucionet, festivalet dhe organizatat tjera të veprimtarisë filmike dhe e prezanton Republikën e Maqedonisë në to,
- kryen aktivitetet për nxitjen e investimeve në veprimtarinë filmike në Republikën e Maqedonisë në pajtim me këtë ligj,
- bashkëpunon me shoqatat nga sfera e veprimtarisë filmike,
- mban evidencë për producentët filmikë, distributorët filmikë dhe kinoshfaqësit në Republikën e Maqedonisë,
- mban evidencë për filmat e incizuar që janë financuar me mjete nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë,

- mban evidencë për filmat që distribuohen në kinematë në Republikën e Maqedonisë,
- mban evidencë për filmat që incizohen në Republikën e Maqedonisë,
- kryen kontroll mbi shfrytëzimin me dedikim të mjeteve të ndara nga Agjencia dhe
- njëherë në vit në Ministrinë e Kulturës dhe në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë dorëzon raport vjetor për punën e saj, me indikatorë financiarë dhe e publikon atë në ueb faqen e Agjencisë.

Mjetet për punë të Agjencisë

Neni 11

(1) Mjetet e nevojshme për punën e Agjencisë sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë dhe nga burimet tjera të përcaktuara me këtë ligj.

(2) Agjencia merr mjete edhe nga:

- të hyrat personale nga financimi i projekteve filmike,
 - kryerja e shërbimeve në kompetencë të saj,
- bashkëpunimi me organizatat dhe institucionet ndërkombëtare,
- kompensimet e personave juridikë të përcaktuar në këtë ligj,
- dotacionet, donacionet, sponzorimet, dhuratat, testamentet dhe burimet tjera të përcaktuara me ligj dhe
- të hyrat nga menaxhimi me mjetet e lira monetare të Agjencisë.

(3) Nëse me punën e Agjencisë realizohen të hyra më të mëdha nga shpenzimet, ato do të shfrytëzohen vetëm për punët nga neni 10 i këtij ligji për të cilat është themeluar Agjencia.

Bazat për përcaktimin e kompensimeve nga personat juridikë

Neni 12

(1) Kompensimet nga neni 11 paragrafi (2) alineja (4) e këtij ligji, të cilat i merr Agjencia janë:

- 1,1% nga të hyrat e serviseve të programit televiziv në nivel nacional,
- 1,1% nga të hyrat e serviseve të programit televiziv në nivel rajonal,
- 1,1% nga të hyrat e serviseve të programit televiziv në nivel lokal,
- 2,5% nga të hyrat e operatorëve kabllovikë që bëjnë ritransmetim të programeve televizive,
- 2,5% nga të hyrat e subjekteve që sigurojnë vetëm shërbime të internetit,
- 5% nga të hyrat e personave juridikë që kryejnë veprimtari kinoshfaqje të filmave,
- 3% nga të hyrat e personave juridikë që kryejnë veprimtari shpërndarje, huazim ose shitje të filmave dhe
- 1,3% nga të hyrat e personave juridikë që kryejnë veprimtari organizim të lojërave të fatit dhe të lojërave argëtuese.

(2) Kompensimet nga paragrafi (1) i këtij neni, personat juridikë i përlllogarisin nga të hyrat e përgjithshme bruto në nivel vjetor.

Procedura për pagesën e kontributeve në Agjenci

Neni 13

(1) Agjencia pas të dhënave të marra nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë për të hyrat e realizuara nga kryerja e veprimtarisë, personave juridikë nga neni 12 i këtij ligji, njëherë në vit në muajin mars në vitin rrjedhës për vitin paraprak, u lëshon aktvendim për përcaktimin e lartësisë së kompensimeve.

(2) Personat juridikë nga neni 12 i këtij ligji, në afat prej 30 ditësh nga marrja e aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij neni, i paguajnë kompensimet në llogarinë e Agjencisë.

(3) Nëse personat juridikë, kompensimet nga neni 12 i këtij ligji, në afatin nga paragrafi (2) i këtij neni, nuk i paguajnë në llogarinë e Agjencisë, Agjencia do të paraqet padi kundër tyre në gjykatën kompetente.

Organet e Agjencisë

Neni 14

Organe të Agjencisë janë drejtori dhe Këshilli Drejtues.

Drejtori i Agjencisë

Neni 15

- (1) Agjencinë e udhëheq drejtori.
- (2) Drejtorin e Agjencisë e emëron dhe e shkarkon Qeveria e Republikës së Maqedonisë.
- (3) Drejtori emërohet me mandat prej dy vitesh dhe mund të riemërohet vetëm edhe një mandat.
- (4) Drejtor i Agjencisë mund të emërohet personi i cili i përmbush kushtet në vijim:
 - të ketë të kryer arsim të lartë nga sfera e filmit ose shkencave shoqërore ose Fakultet juridik me provim të dhënë të jurisprudencës ose Fakultet ekonomik,
 - të ketë së paku pesë vjet përvojë pune në sferën e filmit ose drejtësisë ose ekonomisë dhe
 - të ketë njohje aktive të gjuhës angleze që dëshmohet me një prej certifikatave të pranuar ndërkombëtarisht:
- 1) TOEFEL (TOEFEL)- së paku 74 pikë për dhënie elektronike nëpërmjet kompjuterit, jo më e vjetër se dy vjet nga dita e lëshimit,
- 2) IELTS (IELTS)- së paku 6 pikë, jo më e vjetër se dy vjet nga dita e lëshimit,
- 3) TOLES (TOLES) - njohje elementare (Foundation level),
- 4) ILEK (ILEC) - e dhënë me sukses së paku B 2 ose
- 5) Certifikata e Kembrixhit për anglishte preliminare (Cambridge Certificate of Preliminary English) - B 1 (B 2).

Neni 16

- (1) Drejtorit të Agjencisë i ndërpritet mandati sipas fuqisë së ligjit në një prej rasteve në vijim:
 - me kërkesë të tij personale, përkatësisht dorëheqje të parashtruar në formë me shkrim,
 - nëse është i dënuar për vepër penale me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor me të cilin është shqiptuar dënim me burg prej së paku gjashtë muajsh,
 - nëse tek ai është shkaktuar paaftësi e përhershme ose e përkohshme për kryerje të papenguar të funksionit më gjatë se gjashtë muaj ose nëse është shkaktuar vdekje dhe
 - nëse i plotëson kushtet për realizim të pensionit.
- (2) Drejtori i Agjencisë mund të shkarkohet nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, para skadimit të mandatit për të cilin është emëruar në një prej rasteve në vijim:
 - nëse nuk punon dhe vepron sipas ligjit, statutit dhe akteve të Agjencisë,
 - nëse në afat prej dy vitesh nga dita e emërimit të tij Agjencia nuk tregon rezultate programore dhe financiare,
 - nëse me punën e tij të pandërgjegjshme dhe të padrejtë shkakton çrregullim në kryerjen e punëve të Agjencisë dhe shkakton dëm,
 - nëse Agjencia nuk i grumbullon kompensimet nga neni 12 i këtij ligji,
 - nëse nuk dorëzon raport në pajtim me nenin 19 paragrafi (1) i këtij ligji,
 - nëse edhe pas skadimit të afatit të caktuar në nenin 19 paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji nuk i mënjanon mangësitë dhe/ose në atë afat sërish ka mangësi në punën financiare të Agjencisë dhe
 - nëse Qeveria e Republikës së Maqedonisë nuk e miraton raportin vjetor të Agjencisë.

Neni 17

- (1) Nëse mandati i drejtorit ka skaduar ose është shkarkuar para kohe, Qeveria e Republikës së Maqedonisë do të emërojë ushtrues detyre drejtor.
- (2) Ushtruesi i detyrës drejtor ka mandat deri në emërimin e drejtorit të ri, por jo më gjatë se gjashtë muaj.

Puna e drejtorit

Neni 18

(1) Drejtori i Agjencisë i kryen punën në vijim:

- e përfaqëson Agjencinë dhe përgjigjet për punën materiale-financiare dhe për ligjshmërinë dhe ekonomizimin në punën e saj,
- e udhëheq, organizon, koordinon dhe kontrollon punën e Agjencisë në pajtim me ligjin,
- e propozon Strategjinë për zhvillim të veprimtarisë filmike, me propozim të Këshillit nga neni 22 i këtij ligji, Këshillit Drejtues i propozon se cilat projekte të pranohen, përkatësisht të refuzohen në konkurset për financimin e projekteve me interes nacional në veprimtarinë filmike,
- është i detyruar të ndërmarë masa për grumbullim në kohë të mjeteve nga kompensimet nga neni 12 i këtij ligji dhe për mjetet në bazë të pjesëmarrjes në fitim nga neni 31 i këtij ligji,
- miraton akte dhe lidh marrëveshje në lidhje me realizimin e të drejtës për kthim të mjeteve për nxitjen e investimeve në veprimtarinë filmike,
- i propozon raportin vjetor për punë dhe llogarinë përfundimtare të Agjencisë,
- miraton plan financiar për shfrytëzimin e mjeteve të Agjencisë,
- miraton akt për organizimin e Agjencisë dhe për sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë,
- miraton akte në lidhje me marrëdhënien e punës së të punësuarve,
- lidh marrëveshje me bashkëpunëtorët e jashtëm dhe
- kryen punë tjera të përcaktuara me ligj.

(2) Për kryerjen e punëve në kompetencë të Agjencisë, drejtori i Agjencisë formon këshill filmik, emëron recensentë, këshilltarë dhe bashkëpunëtorë tjerë të jashtëm.

Neni 19

(1) Drejtori i Agjencisë është i detyruar që në çdo gjashtë muaj t'i dorëzojë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë raport për punën e Agjencisë.

(2) Nëse nga raporti nga paragrafi (1) i këtij neni, konstatohet mangësi në punën financiare, përkatësisht nëse konstatohet se kompetencat e Agjencisë nuk zbatohen në pajtim me dinamikën dhe në kuadër të mjeteve të përcaktuara në planin financiar të Agjencisë, drejtori është i detyruar që t'i mënjanojë mangësitë në gjashtë muajt e ardhshëm.

(3) Nëse edhe pas skadimit të gjashtë muajve drejtori nuk i mënjanon mangësitë e konstatuara dhe në atë periudhë sërish ka mangësi në punën financiare të Agjencisë, Qeveria e Republikës së Maqedonisë do ta shkarkojë drejtorin.

Këshilli Drejtues

Neni 20

(1) Me punën e Agjencisë menaxhon Këshilli Drejtues kryetarin dhe anëtarët e të cilit i emëron dhe i shkarkon Qeveria e Republikës së Maqedonisë, me mandat prej dy vitesh, ndërsa mund të riemërohen vetëm edhe një mandat.

(2) Këshillin Drejtues të Agjencisë e përbëjnë kryetari dhe katër anëtarë, prej të cilëve një emërohet nga radhët e individëve të shquar nga sfera e veprimtarisë filmike, një me propozim të asociacionit të shoqatave filmike nga Republika e Maqedonisë ose Dhoma Ekonomike, e cila i përfaqëson producentët filmikë, dy nga radhët e juristëve të diplomuar dhe një nga radhët e ekonomistëve të diplomuar.

(3) Kryetari dhe anëtarët e Këshillit Drejtues të Agjencisë emërohen mbi principin e specialitetit dhe kompetencës dhe përfaqësimit të drejtë të bashkësive në Republikën e Maqedonisë.

(4) Kryetari dhe anëtarët e Këshillit Drejtues mund të shkarkohen edhe para skadimit të mandatit, nëse:

- në bazë të revizionit, konstatohet se punojnë në kundërshtim me ligjin,

- nuk vijnë tri herë të njëpasnjëshme në mbledhjen e Këshillit Drejtues, ndërsa mungesa e tyre nuk është e arsyeshme,

- nëse Agjencia nuk i grumbullon kompensimet nga neni 12 i këtij ligji,

- nëse Agjencia nuk e realizon kompetencën nga neni 10 i këtij ligji për të cilën është themeluar dhe

- nëse Qeveria e Republikës së Maqedonisë nuk e miraton raportin vjetor të Agjencisë.

(5) Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit Drejtues të Agjencisë u takon kompensim në para që e përcakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë me vendim, varësisht nga numri i mbledhjeve të mbajtura dhe prezenca e tyre në mbledhjet.

Neni 21

Këshilli Drejtues i Agjencisë i kryen punët në vijim:

- e miraton Statutin e Agjencisë,

- i miraton vendimet për pranimin apo refuzimin e projekteve për konkurset për financimin e interesit nacional në veprimtarinë filmike,

- i përcakton politikën dhe principet për zhvillim të Agjencisë,

- jep mendim për Strategjinë për zhvillim të veprimtarisë filmike,

- e ndjek realizimin e Strategjisë për zhvillim të veprimtarisë filmike,

- e miraton llogarinë përfundimtare të Agjencisë,

- e miraton raportin vjetor për punën e Agjencisë, me propozim të drejtorit të Agjencisë,

- e miraton rregulloren për punën e vet dhe

- kryen punë tjera të përcaktuara me ligj dhe me Statutin.

Këshilli Filmik

Neni 22

(1) Për kryerjen e punëve profesionale në kompetencë të Agjencisë, si dhe për ndërmarrjen e masave për avancimin e veprimtarisë filmike, drejtori i Agjencisë formon Këshill Filmik të Agjencisë (në tekstin e mëtutjeshëm: këshill).

(2) Këshilli përbëhet prej pesë anëtarëve, të cilët i emëron dhe shkarkon drejtori i Agjencisë nga radhët e individëve të shquar nga sfera e filmit dhe kulturës, me mandat prej dy vitesh.

(3) Këshilli:

- merr pjesë në përgatitjen e konkursit për financimin e projekteve me interes nacional në veprimtarinë filmike nga neni 25 paragrafi (1) i këtij ligji,

- i jep mendim drejtorit të Agjencisë se cilat projekte të dorëzuara në konkursin nga neni 25 paragrafi (1) i këtij ligji, duhet të pranohen përkatësisht refuzohen për konkursin,

- me propozim të këshilltarit financiar nga neni 24 i këtij ligji, nëse ekziston mosharmonizim ndërmjet planit financiar dhe planit operativ me skenarin për projektet e dorëzuara në konkursin nga neni 25 paragrafi (1) i këtij ligji, i propozon drejtorit të Agjencisë që projektet t'i kthejë për përpunim shtesë,

- e përcjell realizimin e projekteve të zgjedhur në konkursin nga neni 25 paragrafi (1) i këtij ligji dhe drejtorit i dorëzon raport për realizimin e tyre dhe

- diskuton për çështje të rëndësishme nga sfera e veprimtarisë filmike.

Recensentët filmikë

Neni 23

(1) Për evaluimin e projekteve të dorëzuara në konkursin nga neni 25 paragrafi (1) i këtij ligji, drejtori i Agjencisë emëron recensent filmik për film artistik me metrazh të gjatë dhe metrazh të shkurtër, recensent filmik për film dokumentar dhe recensent filmik për film të animuar. Mandati i recensentëve filmikë është një vit duke llogaritur nga dita e emërimit.

(2) Recensentët filmikë:

- i lexojnë skenarët e dorëzuara me projektet në konkursin nga neni 25 paragrafi (1) i këtij ligji,

- shkruajnë recensione për skenarët,

- këshillit filmik i propozojnë listë për prioritetet e skenarëve me propozim të projekteve që i rekomandojnë për përkrahje nga Agjencia për konkursin nga neni 25 paragrafi (1) i këtij neni dhe

- japin recension pas përfundimit të filmit për skenarin e të cilit kanë bërë evaluim të projekteve.

Këshilltari financiar

Neni 24

(1) Për vlerësimin e planeve financiare dhe operative dhe buxhetit të projekteve për konkursin nga neni 25 paragrafi (1) i këtij ligji, drejtori i Agjencisë nga radhët e producentëve të shquar filmikë emëron një ose më shumë këshilltarë financiarë.

(2) Këshilltari financiar emërohet me mandat prej një viti.

(3) Këshilltari financiar:

- e analizon dhe kontrollon planin financiar dhe operativ dhe buxhetin të dorëzuara me projektet në konkursin nga neni 25 paragrafi (1) i këtij ligji,

- e përcakton harmonizimin objektiv të planit financiar dhe planit operativ me skenarin dhe

- dorëzon propozim të Këshilli për shumën e mjeteve të cilat duhet të ndahen nga Agjencia për financimin e projekteve të dorëzuara në konkursin nga neni 25 paragrafi (1) i këtij ligji.

(4) Nëse Këshilltari financiar konstaton se ekziston mosharmonizim i planit financiar dhe planit operativ me skenarin i propozon Këshillit që projektin e dorëzuar në konkursin nga neni 25 paragrafi (1) i këtij ligji ta kthejë për përpunim shtesë.

III. FINANCIMI I PROJEKTEVE ME INTERES NACIONAL NË VEPRIMTARINË FILMIKE

Konkurse për financimin e projekteve

Neni 25

(1) Për financimin e projekteve për prodhimin e filmit artistik me metrazh të gjatë ose me metrazh të shkurtër, për film dokumentar dhe për film të animuar (në tekstin e mëtutjeshëm: projekte filmike) Agjencia, në muajin janar në vitin rrjedhës shpall konkurs i cili zgjat gjatë gjithë vitin, ndërsa për projektet e dorëzuara filmike në konkurs vendos dy herë në vit në muajin prill dhe në muajin tetor në vitin rrjedhës.

(2) Për financimin e projekteve me interes nacional në veprimtarinë filmike, Agjencia gjatë vitit shpall edhe konkurs për financimin e projekteve për përkrahjen e shkrimit të skenarëve dhe konkurs për financimin e projekteve për organizimin e festivaleve vendore dhe manifestimeve tjera filmike me karakter ndërkombëtar.

(3) Konkurset nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, shpallen në mjetet për informim publik dhe në ueb faqen e Agjencisë. Konkurset shpallen së paku në një nga gazetatat që botohen në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% të qytetarëve që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase.

(4) Konkurset nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni detyrimisht i përmbajnë:

- kushtet për pjesëmarrje në konkurs,

- prioritetet për financimin e projekteve me interes nacional në veprimtarinë filmike,

- kriteret dhe masa për evaluimin e projekteve,

- lartësinë e pjesëmarrjes së Agjencisë në financimin e projekteve,

- mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve për projekte që do të zgjidhen në konkurs dhe

- informata tjera relevante për konkursin.

Kushte të konkursit për financimin e projekteve filmike

Neni 26

(1) Në konkursin nga neni 25 paragrafi (1) i këtij ligji mund të konkurrojnë producenti filmik i cili është i regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikën e Maqedonisë me veprimtari kryesore - prodhim të filmave.

(2) Producenti filmik i dorëzon Agjencisë kërkesë me dokumentacionin në vijim:

- ekstrakt nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë për veprimtari të regjistruar,
- vërtetim për pjesëmarrje të siguruar personale minimale në shumë prej 4% nga buxheti i përgjithshëm i projektit filmik,
- deklaratë se do t'i sigurojë mjetet tjera financiare të parapara në buxhetin e përgjithshëm të projektit filmik nga burime tjera,
- deklaratë se nëse në konkurs merr mjete nga Agjencia në shumë më tepër se 50% nga buxheti i përgjithshëm i projektit filmik pajtohet që Agjencia të ketë të drejta të barabarta në shfrytëzimin e filmit që do të rregullohet më afërsisht me marrëveshjen nga neni 35 i këtij ligji,
- deklaratë se i ka përmbushur të gjitha detyrimet ndaj Agjencisë, përkatësisht ndaj Ish-Institucionit Nacional Fondi Filmik i Republikës së Maqedonisë - Shkup, për projekte tjera të financuara me mjete nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë,
- paramarrëveshje për të drejtat e rregulluara autoriale me skenaristin dhe regjisorin,
- plan operativ dhe financiar për projektin filmik dhe
- dokumentacion tjetër të përcaktuar me konkursin.

(3) Për projekte filmike për prodhimin e filmit artistik me metrazh të gjatë, mund të konkurrojnë producenti filmik i cili i përmbush kushtet në vijim: producenti filmik të ketë të incizuar dhe publikisht të ketë shfaqur së paku një film artistik me metrazh të gjatë, me të cilin ka marrë pjesë në së paku dy festivale ndërkombëtare që e vërteton me dorëzimin e dokumentacionit përkatës ose regjisori të ketë të incizuar dhe publikisht të ketë shfaqur së paku një film artistik me metrazh të gjatë, me të cilët ka marrë pjesë në së paku dy festivale ndërkombëtare që e vërteton me dorëzimin e dokumentacionit përkatës.

(4) Për projekte filmike për prodhimin e filmit artistik debutues me metrazh të gjatë, mund të konkurrojnë producent filmik i cili i përmbush kushtet në vijim:

- producenti filmik të ketë të incizuar dhe publikisht të ketë shfaqur së paku dy filma dokumentar me metrazh të shkurtër ose filma të animuar me të cilët ka marrë pjesë së paku në dy festivale ndërkombëtare që e vërteton me dorëzimin e dokumentacionit përkatës dhe
- regjisori të ketë të incizuar dhe publikisht të ketë shfaqur së paku dy filma me metrazh të shkurtër me të cilët ka marrë pjesë së paku në dy festivale ndërkombëtare që e vërteton me dorëzimin e dokumentacionit përkatës.

Kritere për financimin e projekteve filmike me interes nacional në veprimtarinë filmike

Neni 27

(1) Financimi i projekteve filmike me interes nacional në veprimtarinë filmike, bëhet në bazë të kritereve themelore në vijim:

- origjinaliteti, autenticiteti dhe cilësia e përmbajtjes së skenarit,
- suksesi i producentit filmik me filma paraprakë të cilat i ka prodhuar, i vërtetuar me pjesëmarrje në festivale filmike vendore dhe ndërkombëtare, numri i shikuesve në sallat e kinemasë në Republikën e Maqedonisë, numri i vendeve në të cilat janë shpërndarë, shitur, përkatësisht shfaqur filmat dhe çmimet e fituara ndërkombëtare,
- suksesi i regjisorit me filma paraprakë për të cilët e ka bërë regjinë, i vërtetuar me pjesëmarrjen në festivale filmike vendore dhe ndërkombëtare, numri i shikuesve në sallat e kinemasë në Republikën e Maqedonisë, numri i vendeve në të cilat janë shpërndarë, shitur, përkatësisht janë shfaqur filmat dhe çmimet e fituara ndërkombëtare dhe

- realizueshmërinë e projektit filmik në lidhje me buxhetin, ndërlikueshmërinë, planin dhe terminet për incizim.

(2) Kriteret më të përafërta dhe masat për vlerësimin e kriterëve për financimin e projektit me interes nacional në veprimtarinë filmike nga paragrafi (1) të këtij neni, i përcakton ministri i Kulturës.

Masat për përcaktimin e kompensimeve

Neni 28

(1) Financimin e projekteve filmike në pjesën e kompensimeve për honorarët autorial dhe honorarët tjerë, Agjencia i kryen sipas masave në vijim:

- për regjisorin, më së shumti deri në 7% të mjeteve të marra nga Agjencia,
- për producentin, më së shumti deri në 7% të mjeteve të marra nga Agjencia,
- për skenaristin, më së shumti 5% të mjeteve të marra nga Agjencia,
- për autorin e veprës letrare sipas së cilës është shkruar skenari, më së shumti deri në 3% të mjeteve të marra nga Agjencia,
- për drejtorin e fotografisë, për skenografin, për kostumografin, për montazhistin, për autorin e muzikës, për dizajnin e audios, për bartësin e rolit kryesor edhe të më së shumti deri në dy role kryesore, më së shumti deri në 3% të mjeteve të marra nga Agjencia,
- për bartësit e roleve tjera, përkatësisht për autorë tjerë të cilët kontribuojnë në film, më së shumti deri në 2% të mjeteve të marra nga Agjencia dhe
- për kompensime për anëtarët tjerë të ekipit filmik, më së shumti deri në 1% të mjeteve të marra nga Agjencia.

(2) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, nëse regjisori, përkatësisht bartësit e roleve kryesore janë fitues të njërit prej çmimeve të festivaleve filmike të afirmuara ndërkombëtare të Kanës, Berlinit, Venecias e të tjera, mund t'u pranohen kompensimet për honorarët autoriale dhe honorarët tjerë edhe më të larta se ato të përcaktuara në paragrafin (1) të këtij neni, për çfarë vendos Këshilli Drejtues i Agjencisë.

Lartësia e pjesëmarrjes së Agjencisë në financimin e projekteve filmike

Neni 29

(1) Agjencia do të marrë pjesë në financimin e projektit filmik me mjete në lartësi deri në më së shumti 70% të buxhetit të përgjithshëm të projektit filmik, por jo më shumë se 62 000 000 denarë.

(2) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, Agjencia do të marrë pjesë në financimin e projekteve filmike për film debutues, me mjete deri në më së shumti 90% nga buxheti i përgjithshëm i projektit filmik, por jo më shumë se 25 000 000 denarë.

(3) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, në financimin e projektit filmik me interes të veçantë për Republikën e Maqedonisë, Agjencia do të marrë pjesë me mjete në lartësi deri në më së shumti 90% të buxhetit të përgjithshëm të projektit filmik, të cilat mund të jenë edhe më shumë se 62 000 000 denarë.

(4) Në mjetet nga paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni janë përfshirë edhe mjetet e dedikuara për marketing, promovim, shpërndarje dhe përpunim të DVD-së së filmit.

Procedura për vendosje për kërkesat e konkursit

Neni 30

(1) Këshilli Drejtues, me propozim të drejtorit, e me mendim paraprakisht të marrë nga Këshilli, miraton vendime për pranim ose refuzim të projekteve filmike për konkursin nga neni 25 paragrafi (1) të këtij ligji.

(2) Këshilli Drejtues, me propozim të drejtorit, miraton vendime për pranimin ose refuzimin e projekteve për konkurset nga neni 25 paragrafi (2) i këtij ligji.

(3) Vendimet nga paragrafi (2) të këtij neni, miratohen në afat prej 60 ditësh nga dita e përfundimit të konkurseve.

(4) Kundër vendimeve të paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni, mund të paraqitet ankesë në afat prej 15 ditësh te Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

(5) Ankesa nuk e prolongon realizimin e vendimeve.

Pjesëmarrja e Agjencisë në fitimin nga filmi

Neni 31

(1) Agjencia ka të drejtë për pjesë të neto fitimit të producentit të filmit, të realizuar nga shfrytëzimi i filmit edhe atë në përqindje që është në lartësi prej 50% nga pjesëmarrja e Agjencisë në financimin e filmit.

(2) Pjesëmarrja e Agjencisë në fitimin nga filmi përcaktohet me marrëveshje për financimin e projektit filmik.

(3) Nëse producenti i filmit në pesë viteve në vijim, duke llogaritur nga dita e shfaqjes së premierës së filmit, nëpërmjet konkursit nga Agjencia merr mjete për realizimin e projektit të ri filmik, Agjencia, përveç mjeteve të marra nga konkursi, do t'ia ndajë edhe mjetet nga fitimi i filmit të tij paraprak, që ai i ka paguar në llogari të Agjencisë në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni. Pas skadimit të pesë viteve, duke llogaritur nga dita e shfaqjes së premierës së filmit, producenti i filmit nuk ka të drejtë t'i shfrytëzojë këto mjete, ndërsa Agjencia do t'i shfrytëzojë mjetet për financimin e projekteve tjera në pajtim me këtë ligj.

(4) Mjetet nga paragrafi (3) të këtij neni, nuk hyjnë në shumën e mjeteve të cilat, në procedurë të përcaktuar me këtë ligj, në konkurs i ndahen producentit të filmit për realizimin e projektit të ri filmik.

(5) Nëse producenti filmik në afat prej 30 ditësh nga miratimi i llogarisë vjetore përfundimtare në vitin paraprak me të cilën është përcaktuar se ka realizuar fitim nga shfrytëzimi i filmit, ndërsa mjetet në shumë të përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni nuk i paguan në llogarinë e Agjencisë, ai nuk ka të drejtë të marrë pjesë në konkurs të Agjencisë në dhjetë vitet e ardhshme.

(6) Ndalimi nga paragrafi (5) të këtij neni, për pjesëmarrje në konkurs të Agjencisë publikohet në ueb faqen e Agjencisë me kumtim të titullit të producentit filmik dhe emrit të themeluesit të personit juridik.

(7) Ndalimi zbatohet edhe për producent filmik ku si themelues paraqitet personi i njëjtë i cili ka qenë themelues i personit juridik, i cili ka marrë ndalim nga Agjencia nga paragrafi (6) të këtij neni.

Konflikti i interesave

Neni 32

(1) Drejtori i Agjencisë, anëtari i Këshillit, recensentët, këshilltarët dhe bashkëpunëtorët tjerë të jashtëm, kryetari dhe anëtarët e Këshillit Drejtues dhe i punësuar në Agjenci, nuk mund të marrin pjesë në konkursin e Agjencisë, e as të marrin pjesë në realizimin e projektit i cili ka marrë mjete nga Agjencia.

(2) Drejtori i Agjencisë, anëtari i Këshillit, recensentët, këshilltarët dhe bashkëpunëtorët tjerë të jashtëm, kryetari dhe anëtarët e Këshillit Drejtues dhe i punësuar në Agjenci janë të obliguar që të japin deklaratë me shkrim me të cilën nën përgjegjësi të plotë materiale, morale dhe penale deklarojnë se nuk kanë konflikt të interesave me kërkesat e parashtruara.

(3) Në rast të ekzistimit të konfliktit të interesave, zbatohet Ligji për pengim të konfliktit të interesave.

Raporti vjetor për punën e Agjencisë

Neni 33

(1) Raporti vjetor për punën e Agjencisë i përmban projektet e zgjedhura në konkurset nga neni 25 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji në vitin paraprak, detyrimet e bartura financiare për realizimin e projekteve filmike nga konkurset paraprake, si dhe mjetet e ndara: për të drejtën e kthimit të mjeteve, për promovim dhe zhvillim të veprimtarisë filmike në Republikën e Maqedonisë, për prezantim të filmit vendor në vend dhe jashtë vendit, për mbështetje të zhvillimit të shpërndarjes së filmave vendor në Republikën e Maqedonisë dhe për mbështetje të zhvillimit të kinemave në Republikën e Maqedonisë.

(2) Këshilli Drejtues me propozim të drejtorit të Agjencisë, e miraton raportin vjetor më së voni deri në fund të muajit mars në vitin rrjedhës për vitin paraprak.

(3) Raporti vjetor në afat prej tetë ditëve nga dita e miratimit publikohet në ueb faqen e Agjencisë.

Paramarrëveshje për financim të projekteve filmike

Neni 34

(1) Producenti filmik projekti filmik i të cilit është zgjedhur në konkursin e nenit 25 paragrafi (1) të këtij ligji, pasi të Agjencia do të paraqesë marrëveshje për të drejta të rregulluara të autorit me skenaristin dhe me regjisorin, lidh paramarrëveshje me drejtorin e Agjencisë, për financimin e projektit filmik. Me paramarrëveshjen rregullohen të drejtat dhe obligimet për shfrytëzimin e mjeteve, dedikimet për shfrytëzim të tyre dhe afati i mbylljes së buxhetit të projektit filmik. Paramarrëveshja verifikohet në noter në cilësi të dokumentit përmbarues.

(2) Me lidhjen e paramarrëveshjes nga paragrafi (1) të këtij neni, Agjencia i paguan producentit filmik më së shumti deri në 5% të mjeteve të përcaktuara në vendimin nga neni 30 paragrafi (1) të këtij ligji, të cilat janë të dedikuara për zhvillimin e projektit filmik dhe për aktivitete për mbylljen e buxhetit të përgjithshëm të projektit filmik me mjete nga burime tjera vendore dhe ndërkombëtare.

(3) Para lidhjes së marrëveshjes nga neni 35 i këtij ligji, producenti filmik, në afatin e përcaktuar në paramarrëveshje, të Agjencia duhet të dorëzojë: marrëveshje me producentë tjerë, persona juridikë dhe fizikë me të cilët vërteton se i ka siguruar në tërësi mjetet e parapara në buxhetin për realizimin e projektit filmik dhe garanci bankare në lartësi prej 25% të shumës së mjeteve të cilat janë siguruar nga Agjencia.

(4) Në rast se nuk i dorëzon marrëveshjet dhe garancinë bankare nga paragrafi (3) të këtij neni, në afatin e paraparë me paramarrëveshjen, producenti filmik është i obliguar në afat prej 60 ditësh në llogari të Agjencisë t'i kthejë mjetet e marra me nënshkrimin e paramarrëveshjes nga paragrafi (2) të këtij neni.

(5) Nëse producenti filmik në afatin nga paragrafi (4) të këtij neni, nuk i kthen mjetet në llogari të Agjencisë, Agjencia kundër tij do të paraqesë padi të gjykata kompetente.

Marrëveshje për financimin e projekteve filmike të zgjedhura në konkurs

Neni 35

(1) Producenti filmik, pas dorëzimit të marrëveshjeve dhe garancisë bankare të nenit 34 paragrafi (3) të këtij ligji dhe buxhetit përfundimtar të filmit me pjesëmarrje të përkufizuar të të gjithë koproducentëve, me drejtorin e Agjencisë lidh marrëveshje për financimin e projektit filmik. Marrëveshja verifikohet në noter në cilësi të dokumentit përmbarues.

(2) Pjesë përbërëse e marrëveshjes janë plani financiar dhe operativ për shfrytëzimin e mjeteve të marra nga Agjencia dhe nga burime tjera.

(3) Me marrëveshjen nga paragrafi (1) të këtij neni, përcaktohet:

- projekti për të cilin ndahen mjetet,
- lartësia e mjeteve të ndara,

- buxheti i përgjithshëm final i filmit,
 - dinamika e pagesës së mjeteve nga Agjencia,
 - mënyra e shfrytëzimit të mjeteve të marra nga Agjencia,
 - pjesëmarrja e Agjencisë në fitimin nga filmi në mënyrë proporcionale me mjetet e investuara të Agjencisë,
 - shfrytëzimi i filmit pa kompensim për nevojat e prezantimit të kulturës së Republikës së Maqedonisë në manifestime ndërkombëtare të organizuara nga Agjencia, Ministria e Kulturës ose nga organe tjera shtetërore,
 - dinamika dhe afati i realizimit të projektit,
 - dorëzimi i raporteve narrative dhe financiare sipas fazave të realizimit të projektit filmik,
 - lartësia e mjeteve për marketing dhe promovim të filmit,
 - kontrolli i shfrytëzimit me dedikim të mjeteve,
 - sanksione për mospërbushjen e obligimeve nga marrëveshja,
 - obligimi për respektimin e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta dhe
 - çështje tjera me të cilat rregullohen të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese.
- (4) Për marrëveshjen nga paragrafi (1) i këtij neni dhe për paramarrëveshjen nga neni 34 i këtij ligji, zbatohen rregullat për marrëdhëniet obligative të Republikës së Maqedonisë.

Neni 36

(1) Projektet filmike të pranuar në konkursin e neni 25 paragrafi (1) të këtij ligji në vitin rrjedhës duhet të realizohen në afat prej pesë vjetësh duke llogaritur nga dita e lidhjes së paramarrëveshjes nga neni 34 të këtij ligji.

(2) Nëse filmi nuk përfundohet në afatin nga paragrafi (1) të këtij neni, producenti filmik është i obliguar që t'i kthejë mjetet e marra nga Agjencia.

(3) Nëse producenti filmik nuk i kthen mjetet e marra nga Agjencia, nuk ka të drejtë të marrë pjesë në konkurs të Agjencisë në dhjetë vitet e ardhshme duke llogaritur nga dita kur me akt të Agjencisë është konstatuar se nuk i ka kthyer mjetet.

(4) Ndalimi për pjesëmarrje në konkurs të Agjencisë publikohet në ueb faqen e Agjencisë.

(5) Nëse producenti filmik nuk ia kthen mjetet Agjencisë, Agjencia kundër tij do të paraqesë padi në gjykatën kompetente.

Neni 37

Së paku 65% e mjeteve të ndara nga Agjencia për financimin e projekteve filmike doemos duhet të shpenzohen në Republikën e Maqedonisë.

Marrëveshje për financimin e projekteve tjera të zgjedhura në konkurs

Neni 38

(1) Personi juridik ose fizik, projekti i të cilit është zgjedhur në konkursin nga neni 25 paragrafi (2) të këtij ligji, pas marrjes së vendimit nga neni 30 paragrafi (2) të këtij ligji, me drejtorin e Agjencisë lidh marrëveshje për financimin e projektit, në të cilën përcaktohen të drejtat dhe obligimet dhe dinamika e shfrytëzimit të mjeteve. Marrëveshja verifikohet në noter në cilësi të dokumentit përmbarues.

(2) Me marrëveshjen nga paragrafi (1) të këtij neni përcaktohet: projekti për të cilin ndahen mjetet, lartësia e mjeteve, mënyra e shfrytëzimit të mjeteve, dinamika dhe afati i realizimit të projektit, dorëzimi i e raporteve, kontrolli mbi shfrytëzimin me dedikim të mjeteve, obligimi për respektimin e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta dhe çështje tjera me të cilat rregullohen të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese.

(3) Për marrëveshjen nga paragrafi (1) i këtij neni zbatohen rregullat për marrëdhëniet obligative të Republikës së Maqedonisë.

Obligimet e shfrytëzuesve të mjeteve

Neni 39

(1) Personi juridik dhe fizik i cili ka marrë mjete në konkurset nga neni 25 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji (në tekstin e mëtejshëm: shfrytëzuesi i mjeteve) është i obliguar që mjetet e marra nga Agjencia me dedikim t'i shfrytëzojë dhe në afat prej 30 ditësh nga përfundimi i projektit të Agjencia të dorëzojë raport narrativ dhe financiar.

(2) Shfrytëzuesi i mjeteve për konkursin nga neni 25 paragrafi (1) të këtij ligji në afat prej 30 ditëve nga përfundimi i filmit, të Agjencia dorëzon raport financiar i cili përmban: specifikim për mjetet e përgjithshme të shpenzuara për realizimin e plotë të filmit, marrëveshje, llogari, fatura dhe ekstrakte të bankave për mjetet e marra nga Agjencia, plan financiar përfundimtar me të gjitha shumat dhe burimet e financimit dhe planin për shpërndarjen e fitimit.

(3) Shfrytëzuesi i mjeteve nga paragrafi (2) të këtij neni është i obliguar që ta respektojë planin financiar dhe operativ të cilët janë pjesë përbërëse e marrëveshjes nga neni 36 i këtij ligji. Shfrytëzuesi i mjeteve është i obliguar që pas secilës fazë të realizimit të projektit filmik të Agjencia të dorëzojë raport për mjetet e shpenzuara që është kusht për marrjen e mjeteve nga Agjencia për fazën e ardhshme të realizimit të projektit filmik.

(4) Nëse ka shmangie nga plani financiar dhe operativ për mjetet e ndara nga Agjencia, shfrytëzuesi i mjeteve është i obliguar që ta njoftojë Agjencinë, e nëse shmangia është në shumë më të madhe se 10% nga mjetet e përgjithshme të marra nga Agjencia, nevojitet të marrë pëlqim nga Këshilli Drejtues. Nëse nuk merr pëlqim nga Këshilli Drejtues, drejtori i Agjencisë do të aktivizojë garancinë bankare, do ta prishë marrëveshjen dhe shfrytëzuesi i mjeteve është i obliguar që t'ia kthejë mjetet Agjencisë me kamatë-vonesë ligjore.

(5) Kontroll mbi shfrytëzimin me dedikim dhe ligjor të mjeteve të marrëveshjes kryen Agjencia. Nëse bëhet fjalë për projekt filmik më të vëllimshëm dhe më të ndërlikuar, Agjencia mund të angazhojë që kontrollin mbi shfrytëzimin me dedikim dhe ligjor të mjeteve nga marrëveshja, ta kryejë revizori i autorizuar.

(6) Shfrytëzuesi i mjeteve është i obliguar që ta mundësojë kontrollin nga paragrafi (5) të këtij neni.

(7) Nëse me raport të kontrollit të kryer konstatohet se mjetet e ndara në konkurs shfrytëzohen në kundërshtim me marrëveshjen, përkatësisht se shfrytëzuesi i mjeteve nuk i respekton afatet dhe obligimet e përcaktuara në marrëveshje, përkatësisht se producenti filmik ua ka bartur të drejtat e filmit dhe mjetet e marra nga Agjencia personave të tretë, drejtori i Agjencisë do të aktivizojë garancinë bankare, do ta prishë marrëveshjen dhe do të miratojë aktvendim me të cilin e ndërpret financimin e mëtejshëm të projektit dhe me të cilin kërkon kthim të mjeteve të ndara nga Agjencia me kamatë vonesë ligjore.

(8) Producentët filmikë të cilët kanë marrë mjete nga Agjencia janë të obliguar që në afat prej 60 ditësh nga dita e përfundimit të filmit të dorëzojnë dëshmi të Agjencia se deri te Institucioni Nacional Kinoteka e Maqedonisë pa kompensim kanë dorëzuar një kopje të filmit të përdorshme për kinoshfaqje në format të përkufizuar në marrëveshjen e nenit 35 të këtij ligji.

(9) Producentët filmikë të cilët kanë marrë mjete nga Agjencia, janë të obliguar që në afat prej dy vjetësh duke llogaritur nga dita e shfaqjes së premierës së filmit, pa kompensim ta ofrojnë filmin për shfaqje televizive në Ndërmarrjen Publike "Radiotelevizioni Maqedonas", në televizionet nacionale, rajonale dhe lokale në Republikën e Maqedonisë.

(10) Nëse në afatin nga paragrafët (8) dhe (9) të këtij neni, producentët filmikë nuk dorëzojnë dëshmi të Agjencia se te Institucioni Nacional Kinoteka e Maqedonisë pa kompensim kanë dorëzuar një kopje të filmit të përdorshme për kinoshfaqje dhe se e kanë ofruar shfaqje televizive nga paragrafi (9) të këtij neni, e humbin të drejtën e pjesëmarrjes në konkurs në dhjetë vitet e ardhshme.

(11) Ndalimi nga paragrafi (10) i këtij neni, për pjesëmarrje në konkurs të Agjencisë publikohet në ueb faqen e Agjencisë.

IV. EVIDENCA, KATEGORIZIMI DHE SHPËRNDARJA E FILMAVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Evidenca unike e të dhënave për veprimtarinë filmike

Neni 40

(1) Agjencia mban: evidencë për producentët filmikë, për distributorët e filmave dhe për kinoshfaqësit në Republikën e Maqedonisë, evidencë të filmave të incizuar me mjete nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, evidencë të filmave që janë incizuar në Republikën e Maqedonisë, evidencë për filmat e shpërndara në kinematë e Republikës së Maqedonisë dhe evidencë për filmat që janë shfaqur në kinematë e Republikës së Maqedonisë.

(2) Evidenca për producentët filmikë, për distributorët e filmave dhe për kinoshfaqësit në Republikën e Maqedonisë, i përmban të dhënat në vijim:

- titullin e personit juridik,
- selinë e personit juridik dhe telefonin për kontakt dhe
- emrin dhe mbiemrin e personit përgjegjës në personin juridik.

(3) Evidenca për filmat e incizuar me mjete të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë i përmban të dhënat në vijim:

- titullin e filmit (origjinal dhe të përkthyer), producentin dhe regjisorin e filmit, buxhetin e përgjithshëm për realizimin e filmit, pjesëmarrjen e Agjencisë në financimin e filmit, vitin e prodhimit të filmit dhe datën e shfaqjes së premierës së tij,

- listën e festivaleve vendore dhe ndërkombëtare në të cilat është shfaqur filmi,
- listën e vendeve në të cilat është distribuuar, përkatësisht shfaqur filmi,
- çmimet e marra për filmin dhe
- numrin e shikuesve në Republikën e Maqedonisë dhe në vende tjera ku është shfaqur filmi.

(4) Evidenca për filmat e incizuar në Republikën e Maqedonisë i përmban të dhënat në vijim:

- titullin e filmit (origjinal dhe të përkthyer),

- emrin, selinë dhe personin përgjegjës të producentit filmik, përkatësisht koprodecentëve të filmit,

- të dhëna për autorët dhe për autorët e kontributeve në film dhe
- shumën e buxhetit të përgjithshëm për realizimin e filmit.

(5) Evidenca për filmat e shpërndarë në Republikën e Maqedonisë i përmban të dhënat në vijim:

- titullin e distributorit të filmit, selinë, telefonin për kontakt dhe emrin dhe mbiemrin e personit përgjegjës në personin juridik,

- titullin e filmit (origjinal dhe të përkthyer),
- vitin e prodhimit,
- vendin e origjinës së filmit,
- regjisorin,
- kategorizimin e filmit dhe
- kohëzgjatjen e të drejtave për shpërndarje të filmit në Republikën e Maqedonisë.

(6) Evidenca për filmat që janë shfaqur në kinematë në Republikën e Maqedonisë i përmban të dhënat si vijon:

- titullin e kinoshfaqësit, selinë, telefonin për kontakt dhe emrin dhe mbiemrin e personit përgjegjës në personin juridik,

- titullin e filmit (origjinal dhe të përkthyer),
- titullin e distributorit,
- formatin në të cilin është shfaqur filmi,
- periudhën kohore të shfaqjes së filmit,
- kategorizimin e filmit,
- numrin e biletave të shitura dhe numrin e projeksioneve dhe

- çmimin neto të biletës.

(7) Personat juridikë të cilët kryejnë veprimtari filmike janë të obliguar që te Agjencia t'i dorëzojnë të dhënat nga paragrafët (2), (3), (4), (5) dhe (6) të këtij neni.

Kategorizimi i filmave për mbrojtjen e personave të mitur

Neni 41

(1) Për mbrojtjen e personave të mitur në Republikën e Maqedonisë nga filma të cilët mund ta dëmtojnë zhvillimin e tyre moral, fizik apo psikik, filmat të cilët shpërndahen në Republikën e Maqedonisë për kinoshfaqje, përkatësisht për formë tjetër të shfaqjes publike, detyrimisht kategorizohen, në mënyrë përkatëse me përmbajtjen e filmit, në pajtim me këtë ligj.

(2) Distributori, përkatësisht kinoshfaqësi i filmit, është i obliguar që para fillimit të shpërndarjes, përkatësisht kinoshfaqjes së filmit në Republikën e Maqedonisë, të bëjë kategorizim të filmit dhe të materialeve promovuese dhe në mënyrë tjetër të qartë dhe të dukshme ta theksojë kategorinë e filmit.

(3) Distributori, përkatësisht kinoshfaqësi i filmit, është i obliguar që së paku shtatë ditë para kinoshfaqjes së parë publike apo para lëshimit në qarkullim të filmit ta njoftojë Agjencinë për kategorizimin e ndarë. Agjencia ka të drejtë që të kërkojë ndryshim të kategorizimit të ndarë, ai nuk është ndarë në pajtim me aktin nga paragrafi (4) të këtij neni.

(4) Mënyrën e kategorizimit të filmit, përkatësisht format e shfaqjes akustike dhe vizuale të kategorisë, si dhe periudhat kohore në të cilat mund të shfaqen përmbajtjet që mund dëmshëm të ndikojnë mbi zhvillimin fizik, psikik dhe moral të fëmijëve dhe të rinjve, i përcakton ministri i Kulturës me akt të përgjithshëm.

Shpërndarja, përkatësisht kinoshfaqja e filmit të huaj në Republikën e Maqedonisë

Neni 42

(1) Film i huaj mund të shpërndahet, përkatësisht të kinoshfaqet në Republikën e Maqedonisë nëse është përkthyer në gjuhën letrare maqedonase në pajtim me ligjin.

(2) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, filmi i huaj mund të shpërndahet, përkatësisht të kinoshfaqet në Republikën e Maqedonisë pa u përkthyer në gjuhën letrare maqedonase, nëse filmi shfaqet në revistë, rivistë të filmave dhe retrospektivë filmike, por nuk guxon të ketë më tepër se një kinoshfaqje.

V. NXITJA E INVESTIMIT TË MJETEVE NË PROJEKT FILMIK, PËRKATËSISHT TELEVIZIV

E drejta e kthimit të mjeteve

Neni 43

(1) Producenti filmik i cili në Republikën e Maqedonisë ka investuar mjete për realizimin e filmit artistik ose dokumentar ose të animuar ose TV film ose TV serial (në tekstin e mëtejme: projekt filmik, përkatësisht televiziv), mund të marrë të drejtën e kthimit të mjeteve të investuara në kushtet e përcaktuara me këtë ligj (në tekstin e mëtejme: e drejta e kthimit të mjeteve).

(2) E drejta e kthimit të mjeteve është 20% e bruto shpenzimeve të bëra në Republikën e Maqedonisë për realizimin e projektit filmik, përkatësisht televiziv në pajtim me këtë ligj.

(3) Kthimi i mjeteve bëhet pas përfundimit të realizimit të projektit filmik, përkatësisht televiziv në Republikën e Maqedonisë, në kushte dhe në procedurë të përcaktuara me këtë ligj.

Neni 44

Të drejtën e kthimit të mjeteve nuk mund ta marrë producenti filmik për mjetet e investuara në Republikën e Maqedonisë për incizimin e veprës reklamuese audiovizuale, komunikim komercial audiovizual, dramë ditore (telenovelë), komedi situate, shou televiziv dhe programe tjera televizive.

Shpenzime të kualifikuara

Neni 45

(1) Shpenzimet nga neni 43 paragrafi (2) të këtij ligji, janë shpenzime të bëra për shërbime dhe për furnizim me mallra për realizimin e projektit filmik, përkatësisht televiziv në Republikën e Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: shpenzime të kualifikuara). Për shpenzime të kualifikuara konsiderohen shpenzimet e bëra për:

1) shërbime për produksion:

- përgatitje për incizim (zgjedhje të lokacioneve, kasting- zgjedhje të aktorëve dhe statistëve, zgjedhje dhe organizim të ekipit, incizime provuese),
- produksion - marrje me qira të zyrave, organizim të incizimit dhe të lokacioneve dhe marrje me qira të pajisjes për zyra,
- kompensime për honorarët autorialë dhe honorarët tjerë për ekipin e filmit nga Republika e Maqedonisë,
- shërbime tjera për produksion (transport – bartje të ekipit, skenografisë dhe pajisjes, vendosje - në hotel ose privat, sigurim dhe katering),
- marrje me qira të pajisjes së produksionit (kamera dhe pajisje shoqëruese, ndriçim, vinçe dhe teknikë skenike, si dhe teknikë të cilët shërbejnë me pajisjen që merret me qira),
- marrje me qira e skenografisë, elementeve skenografike dhe kostumeve (skenografi e përgatitur paraprakisht, si dhe skenografi e bërë veçanërisht për produksion konkret, marrje me qira e kostumeve, mobilie, automjeteve dhe sendeve tjera),
- marrje me qira e lokacioneve për incizim dhe
- dizajn i skenave të produksionit, kostumeve dhe karaktereve, storibord, storibord animatik/i animuar, previz/animacion i ashpër, incizime provuese, test-animacione, dizajn i efekteve vizuale.

2) shërbime për nevojat e postproduksionit:

- montazh i zërit dhe i fotografisë (videomontazh, digital intermediate - kolorkorrigjim, montazh i zërit, miks i zërit, efekti zërimi) dhe
- efekte vizuale digjitale - shërbime informatike - teknologjike;

3) shërbime për nevojat e animacionit:

animacion digjital, përkatësisht shërbime informatike - teknologjike dhe

4) furnizim me mallra për përpunim të skenografisë dhe kostumografisë për nevojat e projektit filmik, përkatësisht televiziv.

(2) Shpenzime të kualifikuara nuk konsiderohen shpenzimet e bëra për:

- blerjen e patundshmërive, mallit i cili i nënshtrohet akcizave dhe mjeteve motorike,
- kompensime autoriale dhe kompensime tjera të paguara jashtë Republikës së Maqedonisë,
- shpenzime për marketing të projektit filmik, përkatësisht televiziv,
- shpenzime për shpërndarjen e projektit filmik, përkatësisht televiziv dhe
- shpenzime për shfaqjen e projektit filmik, përkatësisht televiziv.

(3) Shpenzimet e kualifikuara përcaktohen në bazë të dokumentacionit të parashtruar për pagesën e kryer të nenit 53 paragrafi (1) të këtij ligji.

(4) Shpenzimet nga paragrafi (1) të këtij neni, duhet të jenë me shuma të cilat nuk janë më të larta se çmimet reale në Republikën e Maqedonisë për llojin e shërbimit, përkatësisht për furnizimin me mall.

Kushtet për marrjen e kthimit të mjeteve

Neni 46

(1) Që të mund ta marrë të drejtën e kthimit të mjeteve, producenti filmik nga Republika e Maqedonisë duhet t'i plotësojë kushtet në vijim:

- mjetet të cilat i ka shpenzuar për realizimin e projektit filmik, përkatësisht televiziv në Republikën e Maqedonisë, të mos jenë siguruar nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, por nga burime tjera vendore ose të huaja,

- paraprakisht t'i ketë shlyer të gjitha tatimet, kontributet dhe taksat tjera publike në Republikën e Maqedonisë,
- kundër tij të mos jetë ngritur procedurë falimentuese ose për likuidim në Republikën e Maqedonisë,
- shuma minimale e mjeteve të investuara për shpenzime të kualifikuara për realizimin e projektit filmik, përkatësisht televiziv në Republikën e Maqedonisë, të mos jetë më i vogël se 100 000 euro në kundërvlerë me denarë dhe
- të ketë incizuar si producent ose koproducent dhe të ketë të shfaqur publikisht së paku një film artistik me metrazh të gjatë.

(2) Mjetet nga paragrafi (1) alineja 4 të këtij neni, përlllogariten në kundërvlerë me denarë sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë në ditën e paraqitjes së kërkesës për kthimin e mjeteve nga neni 47 të këtij ligji.

Procedura për realizimin e të drejtës për kthimin e mjeteve

Neni 47

(1) Producenti filmik nga Republika e Maqedonisë, së paku 15 ditë para fillimit të realizimit të projektit filmik, përkatësisht televiziv në Republikën e Maqedonisë, parashtrohet kërkesë te Agjencia për marrjen e vërtetimit për plotësimin e kushteve për marrjen e të drejtës së kthimit të mjeteve.

(2) Gjatë koproduksionit vendor, në të cilin të gjithë koproducentët janë producentë filmikë nga Republika e Maqedonisë, koproducentët ndërmjet veti autorizojnë një producent filmik i cili si bartës i projektit do të marrë pjesë në procedurat e lidhura me kthimin e mjeteve në pajtim me këtë ligj.

(3) Gjatë koproduksionit ndërkombëtar, në të cilin një nga koproducentët është producent filmik nga Republika e Maqedonisë, producenti filmik nga Republika e Maqedonisë është bartës i projektit i cili do të marrë pjesë në procedurat e lidhura me kthimin e mjeteve në pajtim me këtë ligj.

(4) Gjatë produksionit tërësisht të huaj, pavarësisht nga numri i producentëve dhe shteteve nga të cilat vijnë, producenti i huaj filmik i cili është bartës i projektit është i obliguar që të angazhojë producent filmik nga Republika e Maqedonisë i cili si servis i produksionit do të marrë pjesë në procedurat e lidhura me kthimin e mjeteve në pajtim me këtë ligj.

Dokumentacioni i detyrueshëm

Neni 48

(1) Në shtojcë të kërkesës nga neni 47 paragrafi (1) i këtij ligji, producenti filmik nga Republika e Maqedonisë, duhet të dorëzojë:

- ekstrakt nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë për kryerjen e veprimtarisë prodhim i filmave,
- marrëveshje të koproduksionit ose marrëveshje për servis të produksionit për realizimin e projektit filmik, përkatësisht televiziv,
- vërtetim nga organi kompetent për tatime të paguara me rregull, kontribute dhe taksa tjera publike në Republikën e Maqedonisë,
- skenar dhe përmbajtje të shkurtër (sinopsis) për projektin filmik, përkatësisht televiziv për realizimin e të cilit kërkohet kthimi i mjeteve,
- buxhet për projektin filmik, përkatësisht televiziv për të cilin kërkohet kthimi i mjeteve, me pasqyrë të shpenzimeve të planifikuara të kualifikuara në Republikën e Maqedonisë,
- plan operativ për realizimin e projektit filmik, përkatësisht televiziv me data përfundimtare të fillimit dhe të përfundimit të realizimit të filmit, përkatësisht projektit televiziv në Republikën e Maqedonisë dhe
- dëshmi se si producent ose koproducent ka incizuar dhe ka shfaqur publikisht një film artistik me metrazh të gjatë.

(2) Gjatë koproduksionit ndërkombëtar, producenti filmik nga Republika e Maqedonisë me kërkesën është i obliguar të dorëzojë edhe kopje të verifikuar në noter nga marrëveshja për koproduksion.

(3) Gjatë produksionit tërësisht të huaj, producenti filmik nga Republika e Maqedonisë është i obliguar të dorëzojë edhe kopje të verifikuar në noter nga marrëveshja për servis të produksionit për realizimin e projektit filmik, përkatësisht televiziv.

(4) Dokumentacioni nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni, dorëzohet në gjuhën origjinale dhe në përkthim në gjuhën maqedonase, të verifikuar nga përkthyesi i autorizuar.

Vërtetimi për plotësimin e kushteve për të drejtën e kthimit të mjeteve

Neni 49

1) Drejtori i Agjencisë me propozim të Komisionit për të drejtën e kthimit të mjeteve, në afat prej 15 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës nga neni 47 të këtij ligji, parashtruesit të kërkesës i jep vërtetim për plotësimin e kushteve për të drejtë të kthimit të mjeteve.

(2) Drejtori i Agjencisë jep vërtetime vetëm në kuadër të mjeteve të siguruar në buxhetin e Agjencisë me dedikim për të drejtën e kthimit të mjeteve, në vitin rrjedhës.

Neni 50

(1) Komisionin për të drejtën e kthimit të mjeteve nga neni 49 paragrafi (1) të këtij ligji, e emëron dhe shkarkon Qeveria e Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni).

(2) Komisioni ka kryetar dhe katër anëtarë, në përbërje:

- një producent filmik nga Republika e Maqedonisë me propozim të ministrit të Kulturës,
- tre persona të punësuar në Drejtorinë për të hyra publike me propozim të drejtorit të Drejtorisë dhe

- një i punësuar në Agjencinë me propozim të drejtorit të Agjencisë.

(3) Komisioni nga paragrafi (1) të këtij neni është kompetent që:

- t'i shqyrtojë kërkesat e dorëzuara për të drejtën e kthimit të mjeteve,
- të përcaktojë nëse producenti filmik nga Republika e Maqedonisë i plotëson kushtet nga neni 46 të këtij ligji,

- të përcaktojë nëse me kërkesën është dorëzuar dokumentacioni i nevojshëm nga neni 48 të këtij ligji,

- t'i propozojë drejtorit që të japë vërtetim për plotësimin e kushteve për marrjen e të drejtës së kthimit të mjeteve nga neni 49 të këtij ligji,

- të kryejë kontroll të dëshmimeve nga neni 53 të këtij ligji,
- të përcaktojë nëse dëshmitë e dorëzuara për pagesë të kryer për shpenzimet e kualifikuara janë në pajtim me çmimin real në Republikën e Maqedonisë dhe

- t'i propozojë drejtorit që të miratojë aktvendim për pagesën e mjeteve ose për refuzimin e kërkesës për të drejtën e kthimit të mjeteve.

(4) Punët profesionale administrative për komisionin i kryen Agjencia.

Neni 51

(1) Kryetari dhe anëtarët të komisionit kanë mandat prej dy vjetësh, pas kësaj mund edhe një herë të emërohen.

(2) Komisioni punon sipas rregullores të cilën e emëron në mbledhjen e vet të parë.

(3) Kryetarit dhe anëtarëve të komisionit u takon kompensim të cilin e përcakton drejtori i Agjencisë, varësisht nga numri i mbledhjeve të mbajtura dhe numri i kërkesave të shqyrtuara.

Neni 52

(1) Kryetari dhe anëtarët e komisionit janë të obliguar që të japin deklaratë me shkrim me të cilën nën përgjegjësi të plotë materiale, morale dhe penale deklarojnë se nuk kanë konflikt të interesave me kërkesat e parashtruara për të drejtën e kthimit të mjeteve.

(2) Në rast të ekzistimit të konfliktit të interesave, zbatohet Ligji për pengim të konfliktit të interesave.

Kthimi i mjeteve

Neni 53

(1) Në afat prej më së shumti prej 45 ditëve pas përfundimit të realizimit të projektit filmik, përkatësisht televiziv në Republikën e Maqedonisë, producenti filmik të cilit i është dhënë vërtetim nga neni 49 paragrafi (1) të këtij ligji, është i obliguar të Agjencia ta dorëzojë dokumentacionin në vijim:

- përlllogaritje të shpenzimeve të kualifikuara për projekt filmik, përkatësisht televiziv të bëra në Republikën e Maqedonisë,

- dëshmi (fatura/llogari, specifikime, marrëveshje) për pagesa të kryera për shpenzime të kualifikuara të bëra për realizimin e projektit filmik, përkatësisht televiziv në Republikën e Maqedonisë dhe

- raport të revizionit për realizim financiar të projektit filmik, përkatësisht televiziv, të përgatitur nga revizori i pavarur, i angazhuar nga ana e Agjencisë, e me shpenzim të producentit filmik.

(2) Komisioni nga neni 50 të këtij ligji, përcakton nëse dëshmitë e dorëzuara për pagesën e kryer për shpenzime të kualifikuara janë në pajtim me çmimin real të shpenzimeve për llojin në fjalë të shërbimeve të bëra, përkatësisht mallrave të furnizuara në Republikën e Maqedonisë. Nëse shpenzimet janë në shumë më të lartë se çmimet reale në Republikën e Maqedonisë, Komisioni mund të kërkojë që të arsyetohen shkaqet për shumat më të larta të çmimeve dhe nëse edhe pas arsyetimit plotësues përcaktohet se shuma nuk është reale, do të pranohet vetëm shuma e cila përkon me çmimin real.

(3) Me përjashtim nga paragrafi (2) të këtij neni, Komisioni mund të kërkojë që Agjencia të angazhojë vlerësues të autorizuar i cili do ta përcaktojë çmimin real për shpenzimet e bëra.

(4) Komisioni përcakton nëse shpenzimet e kualifikuara nga përlllogaritjet nga paragrafi (1) alineja 1 të këtij neni, janë bërë për shërbime dhe furnizim të mallrave nga neni 45 të këtij ligji, kryen kontroll të dëshmimeve nga paragrafi (1) alinetë 2 dhe 3 të këtij neni dhe përcakton nëse është dorëzuar raport i revizionit nga paragrafi (1) alineja 3 të këtij neni.

(5) Drejtori i Agjencisë me propozim të komisionit në afat prej më së shumti 30 ditë nga dita e dorëzimit të dëshmimeve nga paragrafi (1) të këtij neni miraton aktvendim për pagesë të mjeteve producentit filmik, në bazë të kthimit të mjeteve.

(6) Nëse komisioni përcakton se shpenzimet nga përlllogaritja nga paragrafi (1) alineja 1 të këtij neni, nuk janë në pajtim me nenin 45 të këtij ligji, përkatësisht dëshmitë nga paragrafi (1) alinetë 2 dhe 3 të këtij neni nuk janë në pajtim me këtë ligj dhe ligj tjetër, përkatësisht se me raportin e revizionit është konstatuar parregullsi në punën e producentit filmik të bëra në lidhje me projektin filmik, përkatësisht televiziv ose nëse përcakton se producenti filmik nuk e ka dorëzuar dokumentacionin e nevojshëm nga paragrafi (1) të këtij neni, do t'i propozojë drejtorit të Agjencisë të miratojë aktvendim me të cilin kërkesa për pagesën e mjeteve refuzohet dhe humbet e drejta e kthimit të mjeteve.

VI. DISPOZITA KUNDËRVAJTËSE

Neni 54

Gjobë në shumë prej 2 000 deri në 2 500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje drejtorit, anëtarëve të Këshillit nga neni 22 të këtij ligji, recensentëve nga neni 23 të këtij ligji, këshilltarëve nga neni 24 të këtij ligji, kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit drejtues të Agjencisë dhe anëtarëve të komisionit nga neni 50 të këtij ligji, të punësuarit në Agjencinë dhe bashkëpunëtorit të jashtëm të emëruar nga drejtori i Agjencisë, nëse marrin pjesë në konkurset e Agjencisë me projekte të veta.

Neni 55

(1) Gjobë në shumë prej 1 000 deri në 1 500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik, nëse:

- nuk i paguan mjetet nga fitimi i realizuar në llogari të Agjencisë (neni 31),
- padedikim ose në kundërshtim me marrëveshjen i shfrytëzon mjetet e marra nga Agjencia (neni 39),
- nuk dorëzon te Agjencia raport për filmin në pajtim me këtë ligj (nenet 38 dhe 39),
- nuk mundëson kontroll të shfrytëzimit të mjeteve në pajtim me këtë ligj (neni 36 paragrafi (5)),
- nuk dorëzon të dhëna te Agjencia (neni 40),
- nuk e kategorizon filmin para shpërndarjes së tij, përkatësisht kinoshfaqjes në Republikën e Maqedonisë ose nuk e shpall kategorizimin në mënyrë të përcaktuar me këtë ligj ose nuk e njofton Agjencinë për kategorizimin e ndarë ose nuk e ndryshon kategorizimin me kërkesë të Agjencisë (neni 41) dhe
- shpërndan, përkatësisht kinoshfaq film pa qenë i përkthyer në gjuhën maqedonase (neni 42).

(2) Gjobë në shumë prej 700 deri në 1 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet edhe personit përgjegjës të personit juridik për kundërvajtjen nga paragrafi (1) të këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 700 deri në 1 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit fizik për kundërvajtjen nga paragrafi (1) alinetë 2 dhe 4 të këtij neni.

Neni 56

(1) Gjobë në shumë prej 15 000 deri në 20 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik, nëse në afat prej 30 ditësh pas marrjes së aktvendimit, nuk i paguan kompensimet në llogari të Agjencisë (neni 13 paragrafi (2)).

(2) Gjobë në shumë prej 7 000 deri në 10 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet edhe personit përgjegjës të personit juridik për kundërvajtjen nga paragrafi (1) të këtij neni.

Kompetenca e gjykatës

Neni 57

Për kundërvajtjet nga nenet 54, 55 dhe 56 të këtij ligji, procedurë për kundërvajtje udhëheq gjykata kompetente.

Barazimi

Neni 58

(1) Për kundërvajtjet nga nenet 54, 55 dhe 56 të këtij ligji, inspektorët për kulturë janë të obliguar që kryerësit të kundërvajtjes t'i propozojnë procedurë për barazim para se të parashtrijnë kërkesë për procedurë kundërvajtëse.

(2) Inspektori për kulturë mund në procedurën për barazim kryerësit të kundërvajtjes t'i japë urdhërpagesë.

(3) Nëse kryerësi e pranon urdhërpagesën është i obliguar që të njëjtën ta nënshkruajë. Pranimi i urdhërpagesës për kryerësin e kundërvajtjes shënohet në procesverbal.

Dispozitë ndëshkuese

Neni 59

Nëse drejtori i Agjencisë nuk ndërmerr masa për grumbullim në kohë të mjeteve nga kompensimet nga neni 12 të këtij ligji dhe të mjeteve në bazë të pjesëmarrjes në fitim nga neni 31 të këtij ligji, do të përgjigjet për keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe autorizimit në pajtim me Kodin penal.

VII. MBIKËQYRJA

Neni 60

Mbikëqyrje mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji kryen Ministria e Kulturës.

VIII. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 61

(1) Institucioni Nacional Fondi Filmik i Republikës së Maqedonisë e ndërpret punën si institucion nacional dhe vazhdon me punë si Agjencia e Filmit e Republikës së Maqedonisë nga dita e emërimit të drejtorit të Agjencisë.

(2) Qeveria e Republikës së Maqedonisë, në afat prej 15 ditëve nga dita e fillimit të zbatimit të këtij ligji, do të emërojë drejtor të Agjencisë.

(3) Aktin për organizim të brendshëm dhe për sistematizim të vendeve të punës të Agjencisë, do ta miratojë drejtori i Agjencisë në afat prej 30 ditëve nga dita e emërimit të tij.

(4) Me ditën e emërimit të drejtorit të Agjencisë, Agjencia e merr dokumentacionin, arkivin dhe mjetet tjera për punë, hapësirën dhe pajisjen, si dhe kërkesat, detyrimet dhe borxhet nga Institucioni Nacional Fondi Filmik i Republikës së Maqedonisë.

Neni 62

(1) Mjetet e nevojshme për fillim me punë të Agjencisë sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë në shumë të përcaktuar në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë, për financimin e veprimtarisë filmike në vitin paraprak.

(2) Të punësuarit në Institucionin Nacional Fondi Filmik i Republikës së Maqedonisë me ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji vazhdojnë me punë në Agjenci, si nëpunës shtetërorë, ndërsa të drejtat dhe detyrimet e marrëdhënies së punës i realizojnë në pajtim me rregullat për nëpunës shtetërorë, përveç të punësuarve në Agjenci të cilët kryejnë punë ndihmëse dhe teknike, ndërsa të drejtat dhe detyrimet e marrëdhënies së punës i realizojnë në pajtim me rregullat e përgjithshme për marrëdhënie pune.

Neni 63

(1) Procedurat e filluara sipas Konkursit për financim të projekteve me interes nacional në veprimtarinë filmike për vitin 2014, të shpallur nga Institucioni Nacional Fondi Filmik i Republikës së Maqedonisë në vitin 2013, do të përfundohen në pajtim me Ligjin për Fondin Filmik të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 70/2006, 92/2008, 36/11, 136/11 dhe 136/12).

(2) Kompensimet nga neni 12 të këtij ligji për vitin 2013, do të paguhen në llogari të Agjencisë, duke filluar nga 1 janari 2014.

Neni 64

(1) Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj, do të miratohen në afat prej 60 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Qeveria e Republikës së Maqedonisë do ta miratojë strategjinë në afat prej gjashtë muajsh nga dita e fillimit të zbatimit të këtij ligji.

Neni 65

Me ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji shfuqizohet Ligji për fondin filmik të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 70/2006, 92/2008, 36/11, 136/11 dhe 136/12).

Neni 66

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të zbatohet nga 1 janari 2014.